



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL  
MINISTRI

Nr. ~~4666~~ / Prot  
4

Tiranë, më 14.10.2019

URDHËR

Nr. 565, datë 14.10.2019

PËR

**PEZULLIMIN E PROCEDURËS SË KONKURRIMIT PUBLIK PËR DHËNIEN  
ME QIRA TË TOKËS BUJQËSORE NË PRONËSI TË SHTETIT**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Ligjit nr.44/2015 Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë, Kreu VII "Dhe vendimet e ndërmjetme", neni 66 "Çështjet paraprake", Ligjit nr. 8318, datë 1.4.1998, "Për dhënie me qira të tokës bujqësore e pyjore, të livadheve dhe kullotave që janë pasuri shtetërore", i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 373, datë 20.06.2018 "Për përcaktimin e kriterëve, të rregullave procedurave dhe kontratës TIP për dhënie me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit";

**URDHËROJ :**

1. Pezullimin e procedurës së konkurrimit publik për dhënie me qira të tokës bujqësore në pronësi të shtetit, në administrim të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, me sipërfaqe 146.0917 ha, për pasuritë nr. 33/1, 34/1, 35/1, 36/1, 37/1, 38/1, 39/1, 41/1, 42/1, 43/1, 44/1, janë pasuri të llojit "Arë" me pronar shtet dhe me vendndodhje në Zona Kadastrale 2085, Karavasta të Re, Lushnje, Qarku Fier, me datë zhvillimi 15.10.2019, ora 11.00.
2. Ky pezullim u vendos në zbatim të Ligjit nr.44/2015 Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë, Kreu VII "Dhe vendimet e ndërmjetme", neni 66 "Çështjet paraprake", në të cilin parashikohet se "...Nëse organi publik që zhvillon procedurën përballet me një çështje, zgjidhja e së cilës

është parakusht për zgjidhjen e procedurës dhe që përbën një çështje ligjore të pavarur, për zgjidhjen e së cilës është kompetent një gjykatë ose organ tjetër (“çështja paraprake”), organi publik që zhvillon procedurën administrative pezullon procedurën deri në marrjen e një vendimi të formës së prerë për çështjen paraprake dhe njofton palën në lidhje me këtë....”.

3. Njoftimi për pezullim do të publikohet në Buletinin e Njoftimeve Publike, në ambjentet e njësisë administrative Rremas, bashkisë Divjakë, Agjencisë Rajonale të Ekstencionit Bujqësor Lushnje, në faqen zyrtare të MBZHR-së dhe një gazetë kombëtare.
4. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhëri Grupi i Punës i ngritur me Urdhërin nr. 239/1, datë 9.4.2019

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë,

MINISTRI

  
Bledar Çuçi

